



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-058

Prishtinë, më 3 prill 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË TË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 3 PRILL 2012

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletqi dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi, Bilall Sherifi dhe Skënder Reçica;

Nga administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga Zyra e Presidentit: Amir Haradinaj

Nga OSBE-ja, Floriana Shala.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Kryesia i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e

1. Propozimi i datës për vazhdimin e seancës plenare të ndërprerë më 29 mars 2012.

Lidhur për caktimin e datës për vazhdimin e seancës plenare, të ndërprerë më 29 mars 2012 diskutuan: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti dhe Petar Miletqi, nënkryetarë të Kuvendit, Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini dhe Myzejene Selamni, kryetarë të Grupeve Parlamentare, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesia, pas këtyre diskutimeve, vendosi që seanca plenare e ndërprerë më 29 mars 2012, t'i vazhdojë punimet të enjten, më 5 prill 2012, me këtë

R e n d d i t e

1. Informatë e ministrit të Punëve të Brendshme për ngjarjen në kufi me Serbinë, më 31 mars 2012,
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bibliotekat në Republikën e Kosovës,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkesve,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për lojërat e fatit,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për fondet pensionale në Kosovë,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare,
7. Kërkesa e Qeverisë së Republikës së Kosovës, për tërheqjen e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-168 për turizmin dhe shërbimet turistike,
8. Shqyrtimi Planit Hapësinor i Zonës me interes të veçantë "Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së në Kleçkë dhe Divjakë".

Lidhur me pikën e parë të rendit të ditës, për seancë plenare më 5 prill 2012, Kryesia nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohehet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht nga ministri i Punëve të Brendshme që ta përgatitë një Informatë lidhur me ngjarjen në kufi me Serbinë, më 31 mars 2012.

Lidhur me vazhdimin e seancës plenare, kryetarët e grupeve parlamentare: LDK-së, Ismet Beqiri, AAK-së, Ardian Gjini dhe VV, Visar Ymeri deklaruan se nëse nuk hiqet nga rendi i ditës shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, nuk do të marrin pjesë në seancën e datës 5 prill 2012.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën **12:05** minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale